



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

GJETJET E VROJTIMIT “MBI BASHKËVEPRIMIN BASHKI-BIZNES”

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Dhjetor 2019

Përmbajtja

- I. Objekti dhe Metodologjia**
- II. Biznesi dhe Qeverisja Vendore**
- III. Gjetje & Sugjerime**

Objekti & Metodologjia

Objekti i Vrojtimit

- **Stimulimi i debatit gjithëpërfshirës mbi fakte dhe shqetësime kryesore të biznesit, me fokus ndërveprimin me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore:**
 - Taksa/tarifa vendore
 - Transparenca në nivel vendor
 - Shërbimet përkundrejt tarifave
 - Shërbimet elektronike në nivel vendor


Metoda e përdorur

- Pyetësor i strukturuar
- Plotësuar online në mënyrë rastësore dhe anonime nga 300 biznese
- Publikuar në shqip dhe anglisht në faqen e internetit të KI/LinkedIn/FB/Twitter
- Dërguar me e-mail në rreth 8000 adresa biznesi
- Kontaktuar me telefon rreth 3000 biznese
- Bashkëpunim me Universitetin Epoka për asistencë në përpunim statistikor dhe çertifikim të rezultateve
- Anketa përfshin të dhëna të raportuara gjatë periudhës korrik – shtator 2019

Profil i Kampionit – 300 biznese


Pesha e përgjigjeve sipas rajoneve

2% pa përgjigje




sipas pronësisë

9% pa përgjigje




sipas xhiros vjetore

4% pa përgjigje




sipas sektorit

1% pa përgjigje




sipas vjetërsisë

4% pa përgjigje



Kampioni – Përfaqësimi i eksportuesve



*22% e të anketuarve janë eksportues,
nga të gjitha kategoritë.*



Albania
Investment
Council


Improving Transparency and Investment Climate

Biznesi dhe Qeverisja Vendore

Taksat dhe Tarifat Vendore

A jeni **plotësisht** të informuar në lidhje me taksat dhe tarifatat që paguani, dhe mënyrën e llogaritjes së tyre?

Tirana renditet më mirë në nivel qarku ku 44% e bizneseve raportojnë se janë plotësisht të informuar mbi nivelin e taksave dhe tarifave që paguajnë mesatare më e lartë edhe se mesatarja në rang vendi prej 38%.



Në nivel kombëtar



Bizneset raportojnë se në përgjithësi janë të informuar mbi taksat dhe tarifatat por kanë më pak informacion mbi mënyrën e llogaritjes së tyre....



Njoftimi për pagesën e taksave tarifave vendore, teorikisht duhet të përmbajë edhe mënyrën e llogaritjes si transparencë ndaj bizneseve

Qartësia e informacionit të ofruar nga bashkitë

Si e vlerësoni ju qartësinë e informacionit të ofruar nga Administrata Tatimore Vendore në lidhje me procedurat administrative tatimore vendore?

Elbasani ka renditjen më të mirë në nivel qarku, ku 18% e bizneseve shprehen se informacioni i ofruar nga bashkia është shumë i qartë, mbi mesataren në nivel vendi prej 6%


71% e bizneseve, në rang vendi, raportojnë se informacioni i ofruar nga bashkitë është i **qartë ose shumë i qartë**



Vendimet e Këshillave Bashkiakë


A ju informon Bashkia juaj në lidhje me vendimet më të fundit të Këshillave Bashkiakë dhe ndikimit të tyre në veprimtarinë tuaj?

33% e bizneseve në Shkodër vlerësojnë se bashkia kryen fushata ndërgjegjësimi mbi VKB e miratuara; në Tiranë vetëm 8% e bizneseve raportojnë se bashkia i informon rreth vendimeve më të fundit të KB



Fushata ndërgjegjësimi mbi taksat dhe tarifat, VKB-të mungojnë


88% e bizneseve raportojnë mungesën e informacionit nga bashkitë



Vendimet e Këshillave Bashkiakë


A i vlerësoni si të pajtueshme me legjislacionin në fuqi VKB?

21% e bizneseve në qarkun e Shkodrës
vlerësojnë se VKB janë plotësisht të pajtueshme
me legjislacionin në fuqi
Ndërkohë, **vetëm 8% e bizneseve në Tiranë**
besojnë në pajtueshmërinë e tyre me
legjislacionin në fuqi



**Vetëm 11% e bizneseve në rang
vendi i konsiderojnë të pajtueshme
VKB-të me legjislacionin në fuqi**

**Pajteshmëria me legjislacionin në fuqi, në
nivel kombëtar**




Vendimet e Këshillave Bashkiakë


Sa ndikojnë VKB-të në veprimtarinë e përditshme të biznesit tuaj?

*Në nivel qarku, **19% e bizneseve në Tiranë** deklarojnë se VKB-të ndikojnë shumë përditshmërinë e tyre; ndërkohë, **në qarkun Korçë vetëm 8%** e bizneseve mendojnë se VKB-të kanë ndikim të madh*

*Në rang vendi bizneset deklarojnë se VKB-të kanë **ndikim të madh në përditshmërinë e tyre**, 56% e tyre deklarojnë se VKB-të ndikojnë shumë ose mjaftueshëm përditshmërinë e tyre*



Në nivel kombëtar





Shërbimet për kundërt Tarifave

A e konsideroni të drejtë balancën mes shërbimit të përfituar dhe tarifave vendore që paguani?

*Në **qarkun Korçë** 23% e bizneseve e konsiderojnë si **plotësisht të drejtë** balancën shërbime dhe tarifa e cila renditet shumë mirë në krahasim me mesataren në vend prej 6%;
në Tiranë e Durrës vetëm 4% e bizneseve e konsiderojnë plotësisht të drejtë këtë balancë*


Disbalanca e theksuar mes pagesës dhe shërbimit të përftuar

78% e bizneseve e konsiderojnë pak ose aspak të drejtë




Shërbimet elektronike

A përfitoni shërbime elektronike nga Bashkia juaj?




Nëse po, sa të kënaqur jini me shërbimin elektronik?

Në rang kombëtar



A përfitoni shërbime elektronike nga bashkia juaj?
Në rang kombëtar



Tirana ka renditjen më pozitive në lidhje me shërbimet elektronike të ofruara

Ka pak shërbime elektronike të ofruara nga NjvQV

76% e bizneseve raportojnë se Bashkia nuk ofron shërbime elektronike ose nuk e dine nëse ajo ofron ndonjë shërbim

Konkluzione

Transparenca në nivel lokal

- Bizneset janë *përgjithësisht të informuar mbi legjislacionin fiskal vendor të aplikuar në bashkinë e tyre (86% janë plotësisht/pjesërisht të informuar)*
- Bizneset janë *të informuar mbi procedurat tatimore vendore (71% janë të qartë ose shumë të qartë)*
- Bizneset *nuk janë të informuar në lidhje me VKB e miratuara në Bashkinë e tyre (88% nuk kanë informacion)*

Besueshmëria në nivel lokal

- Bizneset kanë *mungesë besimi në vendimmarrjen e institucioneve vendore në raport me legjislacionin qendror (vetëm 11% mendojnë se VKB janë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin qendror dhe rreth 56% deklarojnë se ndikohen mjaftueshëm nga VKB)*

Raporti Kosto - Përfitim

- Bizneset janë *të pakënaqur nga shërbimet vendore krahasuar me tarifatat e paguara (78% konsiderojnë pak/aspak të drejtë raportin kosto-përfitim) – shembull mjaft i komentuar është tarifa e pastrimit*

Shërbimet elektronike

- Institucionet vendore nuk ofrojnë shërbime elektronike *(76% deklarojnë se nuk përfitojnë shërbime elektronike)*